



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 85, datë 14.8.2016

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.8.2003,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika, 4, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në kreun III, "Përgatitja e projektaktit", të rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Projektakti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.

- a) Në rastin e projektakteve në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, projektakti duhet të shoqërohet me tabelat e përputhshmërisë dhe me aktin ligjor të Bashkimit Evropian, i cili synohet të përafrohet, i përkthyer në gjuhën shqipe.
- b) Në rastin e projektakteve që duhet të konsultohen me publikun, relacioni duhet të shoqërohet me të dhënat për procesin e njoftimit

e të konsultimit publik, sipas formatit në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Shkronja “ë”, e pikës 19, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit, shpjegime në lidhje me identifikimin e grupeve të interesit, pjesëmarrës në konsultim, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe opinionet e shprehura nga grupet e interesit si dhe reflektimin ose jo në projektakt të opinionëve të grupeve të interesit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I SHTETIT PËR
MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

ERMONELA VALIKAJ FELAJ



MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MILENA HARITO



Shtojca I

Tabela për përpunimin e të dhënave në funksion të hartimit të raportit për njoftimin dhe konsultimin publik

Emërtimi i ligjit	Ligji është subjekt i konsultimit publik (Nëse jo, pse)	Koordinatori për konsultimin publik (Neni 10)	Forma e njoftimit (Neni 11, pika 1)	Palët e përfshira në konsultim (Neni 8)	Forma e konsultimit (marja e komenteve dhe rekomandimeve) (Neni 11, pika 2)	Afati i dorëzimit të komenteve dhe rekomandimeve (Neni 15)	A ka patur zgjatje/përsëritje (Neni 16)	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve (Neni 9)	Raporti për transparencë në procesin e vendimmarrjes (Neni 20)	Shqyrtimi i ankesave, nëse ka (Neni 21)
	(Neni 4, pika 1)									